



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 1483 Prot.

Lezhë, më 04 . 02 . 2022

VENDIM

Nr. 9 Datë 01 . 02 . 2022

PËR

Miratimin e kërkesës së Bashkisë Lezhë së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për dëmin e shkaktuar nga djegia e banesës të shtetases Jolanda Zefi, banore në fshatin Gramsh, Njësia Administrative Dajç, Bashkia Lezhë.

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ligjit Nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", VKM Nr.329,dt.16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile, mbi dëmin e shkaktuar në banesën e Znj.J. Z., banore në fshatin Gramsh, Njësia Administrative Dajç Bashkia Lezhë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë

Vendosi:

1.Të miratojë kërkesën e Bashkisë Lezhë për mbështetje financiare të shtetases Znj.J. Z. për dëmtimin e banesës së saj nga zjarri.

A.Të miratojë dëmin e shkaktuar nga zjarri në vlerën	507032 lekë.
a) Dëmi i shkaktuar në ndërtesë	507032 lekë.
b) Dëmi i shkaktuar në orendi, mobilje e pajisje	0 lekë.

B.Mbështetur në VKM. Nr 329, dt.16.05.2012, kap3, pika 3, gërmat b dhe ç, kompensimi për dëmin e shkaktuar në anën ndërtimore të jetë në masën 50%, ndërsa kompensimi për dëmin e shkaktuar në orendi, mobilje e pajisje, mbështetur në kap 3, pika 3, gërma d të VKM-së së mësipërme të jetë sa masa e dëmit të shkaktuar dhe konkretisht :

a) Vlera e kompensimit të dëmit në anën ndërtimore të jetë	253516 lekë.
b) Vlera e kompensimit të dëmit në orendi, mobilje e pajisje	0 lekë.

Vlera totale	253516 lekë.
--------------	--------------

2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Lezhë.

3. Bashkia Lezhe t'i akordojë familjes së shtetases Znj.J. Z. me Nr.ID. I.....C ndihmën emergjente në vlerën prej 253516 (dyqind e pesëdhjetë e tre mijë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë nga buxheti i Bashkisë Lezhë, fondi i Emergjencave Civile i destinuar dhe i miratuar nga Këshilli i Bashkisë për vitin 2022, bazuar në VKM nr.329 dt.16.05.2012.

4. Ndhima financiare që do t'i akordohet do të përdoret për t'i ardhur në ndihmë familjes së shtetases Znj.J. Z., banesa e të cilës është dëmtuar nga zjarri.

5.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

6.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI
ERNEST RAKAJ

